SKEDË INFORMIMI

Mundësi për aplikim të bashkive shqiptare në thirrjen "Demonstrating place-based experimentation and innovation spaces as enabling environments for scaling EU Missions" në kuadër të Horizon Europe

1. Synimi i thirrjes

Thirrja synon të mbështesë autoritetet vendore dhe partnerët e tyre në projektimin, testimin dhe demonstrimin e modeleve inovative të qeverisjes, politikave publike, rregullimit dhe financimit në nivel territorial, për të mundësuar zbatimin në shkallë më të gjerë të zgjidhjeve të provuara në kuadër të Misioneve të BE-së (EU Missions). Ajo lidhet me fazën e dytë të Misioneve të BE-së (2026–2030), me fokus kalimin nga projektet pilot drejt përhapjes së zgjidhjeve në territore të tjera.

Thirrja nuk është e orientuar kryesisht drejt financimit të një teknologjie të veçantë apo investimeve të zakonshme infrastrukturore. Qëllimi është krijimi i kushteve institucionale, rregullatore dhe financiare që mundësojnë zbatimin më të gjerë të inovacioneve ekzistuese.

2. Fushat dhe drejtimet e veprimit

- Modele të qeverisjes shumënivelëshe dhe të koordinimit ndërinstitucional për zbatimin territorial të Misioneve të BE-së.
- Eksperimentim rregullator dhe zhvillim i politikave vendore që lehtësojnë zbatimin e zgjidhjeve inovative.
- Mekanizma inovativë të financimit publik–publik dhe publik–privat, si dhe kombinim i burimeve të financimit.
- Strategji të prokurimit publik inovativ dhe modele të bashkëpunimit ndërsektorial.
- Hapësira territoriale të eksperimentimit, demonstrimit dhe bashkëkrijimit me përfshirjen e qytetarëve, universiteteve, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Projektet mund të mbulojnë një ose disa nga Misionet e BE-së që lidhen me nevojat dhe prioritetet e autoriteteve vendore pjesëmarrëse (p.sh. përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, qytetet klimatikisht neutrale, ujërat dhe oqeanet, toka ose kanceri).

3. Aktivitetet e pranueshme dhe rezultatet e pritshme

- Identifikimi dhe analizimi i pengesave ligjore, financiare, rregullatore dhe institucionale që kufizojnë zgjerimin e zgjidhjeve të provuara.
- Hartimi dhe testimi praktik i modeleve të reja të qeverisjes, financimit dhe politikave në bashki ose territore partnere.
- Zhvillimi i proceseve pjesëmarrëse të bashkëkrijimit dhe angazhimit të vazhdueshëm të grupeve të interesit.
- Përgatitja e modeleve të dokumentuara, të transferueshme dhe të përsëritshme në territore të tjera, përfshirë përdorimin e instrumenteve të ndryshme të financimit të BE-së.

Rezultatet e pritshme përfshijnë forcimin e qeverisjes shumënivelëshe, krijimin e kushteve për përhapjen e inovacioneve dhe shndërrimin e analizave në modele territoriale të testuara dhe praktika të ripërdorshme.

4. Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi kërkohet?

- Mund të marrin pjesë subjekte juridike publike dhe private, përfshirë autoritetet vendore, universitete, institucione kërkimore, organizata jofitimprurëse dhe biznese, në përputhje me rregullat e Horizon Europe.
- Konsorciumi duhet të drejtohet nga autoritete vendore, sipas orientimit specifik të temës.
- Sipas rregullit të përgjithshëm, konsorciumi duhet të ketë të paktën tre subjekte juridike të pavarura nga tre vende të ndryshme: të paktën një nga një shtet anëtar i BE-së dhe dy nga shtete anëtare ose vende të asociuara.
- Shqipëria është vend i asociuar në Horizon Europe; për rrjedhojë, bashkitë shqiptare mund të marrin pjesë si përfituese financimi nëse përmbushin të gjitha kushtet e thirrjes dhe të konsorciumit.

5. Periudha e zbatimit të projekteve

Kohëzgjatja e projekteve përcaktohet në bazë të natyrës, objektivave dhe aktiviteteve të propozuara. Aplikantët duhet të parashikojnë një periudhë zbatimi të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve, arritjen e rezultateve të pritshme dhe përmbushjen e kërkesave të thirrjes. Kohëzgjatja përfundimtare përcaktohet në marrëveshjen e grantit, në përputhje me rregullat e programit Horizon Europe.

6.Buxheti i thirrjes dhe granti

Buxheti tregues i temës	3.620.000 euro
Kontributi i pritshëm i BE-së për projekt	1.000.000–1.500.000 euro
Numri tregues i projekteve që pritet të financohen	Rreth 3
Lloji i veprimit	Innovation Action (IA)
Norma e financimit	70% e kostove të pranueshme; deri në 100% për subjekte juridike jofitimprurëse, sipas rregullave përkatëse të Horizon Europe

Vlerat janë treguese dhe nuk përfaqësojnë financim të garantuar për secilin aplikant ose bashki. Buxheti i projektit dhe shpërndarja ndërmjet partnerëve përcaktohen në propozim.

7. Si bëhet aplikimi?

Aplikimi kryhet elektronikisht në EU Funding & Tenders Portal, në faqen e temës. Në praktikë, bashkia duhet:

- Të regjistrohet ose të verifikojë regjistrimin në Participant Register dhe kodin PIC të subjektit.

- Të identifikojë partnerët e konsorciumit dhe rolin e saj në projekt; të sigurojë përputhjen me kërkesën për drejtim nga autoritetet vendore.
- Të shqyrtojë tekstin e plotë të temës, General Annexes, formularët dhe udhëzimet e paraqitjes.
- Të përgatisë Part A (të dhënat administrative/buxheti) dhe Part B (përshkrimi teknik i propozimit), sipas modeleve në sistem.
- Të dorëzojë aplikimin brenda afatit përmes sistemit elektronik të portalit.

8. Çfarë duhet të ketë parasysh bashkia?

- Të identifikojë një problem real territorial dhe një zgjidhje të provuar, zgjerimi i së cilës pengohet nga faktorë të qeverisjes, financimit ose rregullimit.
- Të lidhë propozimin me një ose disa EU Missions dhe me dokumentet strategjike territoriale dhe vendore.
- Të përcaktojë partnerët, përgjegjësitë, territorin e pilotimit dhe indikatorët e rezultateve të matshme.
- Të demonstrojë përfshirjen e komunitetit dhe të aktorëve relevantë gjatë gjithë projektit.
- Të vlerësojë kapacitetet financiare dhe administrative, normën e financimit dhe rregullat e shmangies së financimit të dyfishtë.
- Të parashikojë transferimin dhe përsëritjen e modelit në bashki ose territore të tjera.

9. Kur është afati i fundit?

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data: **13 janar 2027, ora 17:00, sipas orës së Brukselit.**

10. Linku i thirrjes

https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-MISS-2026-07-CROSS-04